

*AKT-THEMELIM*  
*I*  
*SHOQËRISË*

**TGS Team 2024 sh.p.k.**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,  
UNE, :

**1-Eudon Hoti i biri i Blerim-it i datelindjes 02-08-1996, lindur e banues ne Kamenicë i paisur me leternjoftim me Nr.1174755724.**

Sot me dt. 07/06/2024, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë Akt-  
Themelimi për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **TGS Team 2024**  
sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

*Neni 1*

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me  
Përgjegjësi të Kufizuar **TGS Team 2024 sh.p.k.** .

*Neni 2*

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e  
organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i  
bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

*Neni 3*

Emri i plotë i shoqërisë është **TGS Team 2024** sh.p.k. .

*Neni 4*

Selia e shoqërisë është në **Kukes, Lagjja Nr.3, Rruga Barakat, Zona Kadastrale Nr.2315, Ndertese private Nr.29, Hyrja Nr.1**. Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

*Neni 5*

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **TGS Team 2024** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

**Aktivitetet e tjera të telekomunikimit Aktivitetet e telekomunikimit kabllor. Marredheniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit. Teknologjia tjeter informative dhe aktivitetet sherbyese kompjuterike. Import-eksport.**

*Neni 6*

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare ne **1** kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

*Neni 7*

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Fatlinda Elezkurtaj** dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statut.

*Neni 8*

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24<sup>oo</sup> te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

*Neni 9*

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

*Neni 10*

Ky Akt–Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

**TGS Team 2024** shpk

ADMINISTRATORI

Fatlinda Elez Kurtaj



Ortaku

Eudon Hoti

